



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 11, datë 04.06.2024

P Ë R

MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:

“MORINA CITY” STRUKTURA REZIDENCIALE ME 5 DHE 6 KATE MBI TOKË, 2
KATE NËNTOKË DHE HAPËSIRA SHËRBIMESH TË PËRBASHKËTA”, ME
VENDNDODHJE NË SEGMENTIN E RI TË RRUGËS PALASË-DHËRMI, BASHKIA
HIMARË

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të zhvilluesit shoqërinë “Rinia 04” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Morina City” Struktura rezidenciale me 5 dhe 6 kate mbi tokë, 2 kate nëntokë dhe hapësira shërbimesh të përbashkëta”, me vendndodhje në segmentin e ri të Rrugës Palasë - Dhërmi, Bashkia Himarë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Rinia-04” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Vendimi Nr. 29, datë 29.05.2024 i Këshillit Kombëtar të Territorit, “Për miratimin e lejes së “Morina City”, Struktura rezidenciale me 5+1 kate mbi tokë, me 2 kate nëntokë dhe hapësira shërbimesh të përbashkëta, me vendndodhje në segmentin e ri të rrugës Palasë – Dhërmi, Bashkia Himarë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Rinia 04” sh.p.k, shfuqizohet.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit, hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I


E D I R A M A



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
MIRELA KUMBARO-FURXHI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAIDA ROKA



Nënshkruar më datë 11/06 2025